



**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 178, Datë 08.11.2017**

**MBI**

**MIRATIMIN E METODOLOGJISË SË LLOGARITJES SË TARIFAVE TË  
RRJETIT TË TRANSMETIMIT DHE SHPËRNDARJES SË GAZIT NATYROR**

Në mbështetje të neneve 16 pika 1 dhe nenit 32 pika 1 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”; si dhe në zbatim të nenit 26 të Rregullores për Organizimin, Funkcionimin dhe Procedurat e ERE-s” miratuar me Vendimin nr. 96 datë. 17 .06. 2016; Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 08.11.2017, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, për miratimin e “Metodologjisë së llogaritjes së tarifave të rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror”,

**Konstatohet se,**

- Drejtoritë teknike në bashkëpunim me shoqërinë konsulente BBH kanë hartuar draftin e Metodologjisë së llogaritjes së tarifave të rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror.
- Bordi i ERE-s me Vendimin nr. 142 datë 06.09.2017 vendosi për fillimin e procedurave për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifave të rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror.
- Me shkresën nr. 648 Prot. datë 04.10.2017, ERE njoftoi Albgaz sh.a, Albpetrol sh.a, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe Autoritetin e Konkurrencës, për fillimin e procedurës për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifave të rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror dhe u kërkoi të paraqesin opinionet apo komentet e tyre në lidhje me këtë metodologji.
- Autoriteti i Konkurrencës me shkresën nr. 394/1 Prot., datë 12.10.2017, Albgaz sh.a. me shkresën nr.129 Prot., datë 30.10.2017 dhe ENC në korresponcencë elektronike shprehën opinionin e tyre mbi këtë metodologji. Komentet e palëve sa më sipër që nuk bien ndesh me legjislacionin në fuqi, janë reflektuar në metodologjinë e llogaritjes së tarifave të rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror, .

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE,

**Vendosi:**

- 1 Të miratojë metodologjinë e llogaritjes së tarifave të rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror.(Bashkëlidhur)

- 2 Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Autoritetin e Konkurrencës, Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë si dhe të gjithë të interesuarit për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.